

Hapen 30 qendra shëndetësore verore për sezonin turistik



Hapen 30 qendra shëndetësore verore në zonat turistike, për të ofruar shërbim shëndetësor për pushuesit dhe turistët që do të frekuentojnë Shqipërinë këtë sezon veror. Sistemi shëndetësor do të jetë në gatishmëri përgjatë gjithë sezonit turistik veror, në zonat bregdetare dhe malore në të gjithë vendin, me shërbim 24/7 për pushuesit. Qendrat shëndetësore verore në zonat bregdetare dhe në zonat malore, hapen çdo 15 Qershor, deri në fund të sezonit turistik.



MASTERPLANI I MODERNIZIMIT TË QSUT, NIS NDËRTIMI I SPITALIT TË RI DITOR

Pas ndërtimit të Spitalit Qendror, nis zbatimimi i masterplanit me fazën e dytë, që është ndërtimi i Spitalit Ditor. Investimi që po kryhet në ish-Urgjencën e QSUT tashmë do t'i dedikohet shërbimit ditor, ku do të akomodohet shërbimi i Hematologjisë, Hemodializës, Toksikologjisë, ambiente për mikrokirurgji, lazer, dermatoskopi, dhe zgjerim në numrin e shtretërve për shërbimin e dermatologjisë, alergologji, reumatologji, dhe mjekësi interne.

MANASTIRLIU INSPEKTON FAZËN E DYTË TË PUNIMEVE NË SPITALIN PEDIATRIK

Pas përmbylljes së fazës së parë të investimit në Pediatriinë e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, ka vijuar faza e dytë e investimit për rehabilitimin e plotë të Pediatriisë së Përgjithshme, e cila do të mundësojë të gjithë rindërtimin dhe përfundimin nga themelet të të gjithë strukturës të Pediatriisë së Përgjithshme. Projekti me një kapacitet prej 120 shtretërish, përfshin zgjerimin e shërbimit të onko-hematologjisë, dializës, pneumologjisë, etj. Me përfundimin e fazës së dytë kompletëhet i gjithë korpusi i Spitalit Pediatrik në QSUT.



60 MJEKË TË RINJ SPECIALISTË I ATASHOHEN SPITALEVE RAJONALE DHE BASHKIAKE

60 mjekë të rinj specialistë, me kontratë me MSHMS, do t'i bashkohen ekipeve të spitaleve rajonale e bashkiake, duke plotësuar nevojat për shërbim të specializuar për qytetarët, afër vendbanimit. Nga viti 2019, kur përfunduan specializimin grupi i parë i mjekëve, janë rreth 500 mjekë specialistë me kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë, të punësuar në çdo rajon të vendit.

SPITALI I RI I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME NË SPITALIN E TRAUMËS

Hapet Spitali i ri i Sëmundjeve të Brendshme në Spitalin Universitar të Traumës, i ndërtuar sipas kushteve bashkëkohore, duke krijuar kështu një tjetër qendër reference me standarde evropiane në vendin tonë. Spitali i ri është një investim i qeverisë shqiptare me kapacitete të shtuara, 60 shtretër, dedikuar për shërbimet e kardiologjisë, pneumologjisë, neurologjisë, endokrinologjisë, hematologjisë, nefrologjisë, reumatologjisë dhe psikiatriisë, me standardet më të larta. Për herë të parë do të përfshihet edhe një strukturë ambulatorie me kapacitete të shtuara, duke lehtësuar edhe korpusin qendror nga fluksi ditor dhe duke përmirësuar edhe kohën e pritjes dhe cilësinë e shërbimit për qytetarët.

